



REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorezuar Prijmljeno/Prodato Received/Delivery	14 - 12 2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPNSHUK	8029/2022		1/9



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.931/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Jeton Koca dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.931/2022, të datës 20.10.2022 të ankueses Komuna e Prishtinës, kundër organit të punësimit Ministria e Mbrojtjes, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin dhe 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 13.12.2022, mori:

V E N D I M

- I. **APROVOHET** si e bazuar ankesa me numër A.nr.931/2022 e datës 20.10.2022 e parashtruar nga ankuesja
- II. **ANULOHET** Njoftimi i datës 27.09.2022 për anulimin e procedurës së Lëvizjes Brenda Kategorisë për pozitën "Zyrtar për Analiza të Blerjeve Ushtarake".
- III. **MBETEN në fuqi** Raporti final më numër protokolli:2133 i Komisionit për Lëvizje Brenda Kategorisë i datës 05.08.2022 dhe Njoftimi i datës 05.08.2022 për përzgjedhjen përfundimtare të kandidatit.
- IV. **OBLIGOHET** Njësia e Burimeve Njerëzore e Ministrisë së Mbrojtjes, që ta emërojë ankuesen me Akt Emërim në pozitën "Zyrtar për Analiza të Blerjeve Ushtarake" sipas legjislacionit në fuqi.

V. OBLIGOHET Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mbrojtjes, të ndërmarrë të gjithë veprimet e nevojshme me qëllim të zbatimit të këtij vendimi si në pikën **II** dhe **III** të dispozitivit, në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e pranimi të këtij vendimi.

VI. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesja Kosovare Murseli, e cila sipas shkresave të lëndës është kandidatë për lëvizje brenda kategorisë në kuadër të Ministrisë së Mbrojtjes, me datë 20.10.2022, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila është protokolluar me numër 6313/2022, kundër njoftimit të datës 27.09.2022 lidhur me anulimin e konkursit për pozitën "Zyrtar për Raporte dhe Analiza" me pretendimet ankimore që Këshilli ta obligojë organin kompetent që ankues ti lëshohet akt emërimi pasi që e njëjta është shpallur fituese në këtë konkurs.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (me tej KPMSHCK) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Ministria e Mbrojtjes. Ndërsa me datë 10.11.2022, KPMSHCK-ja ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Me kërkesë të Kryetarit të Kolegjit, Kryetari i Këshillit, bazuar në dispozitat e nenit 17 paragrafi 2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me Vendimin Nr.178 të datë 02.12.2022 ka vazhduar afatin e vendimmarrjen lidhur me këtë çështje ankimore edhe për dhjetë (10) dite pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vendosje meritore, ka administruar këto prova: Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vendosje meritore, ka administruar këto prova: Ankesa e datës 20. 10.2022 parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës; Njoftimi përfundimtarë për kandidatin fitues i datës 05.08.2022; E-mail i dërguar nga J.B drejtuar K.M e datës 05.08.2022; E-mail i dërguar nga J.B drejtuar K.M e datës 12.09.2022; E-mail i dërguar nga K.M drejtuar J.B e datës 15.09.2022 me korrespondencën e bashkangjitur; Vërtetim me nr.07-199/2022 i datës 13.09.2022; Çertifikatë Shëndetësore e datës 13.09.2022; Çertifikatë PN.NR/KR.Br 2302/2022 e datës 13.09.2022; E-mail i dërguar nga J.B drejtuar K.M e datës 27.09.2022; E-mail i dërguar nga J.B drejtuar K.M e datës 27.09.2022; Kërkesë me nr.prot.2666 e datës 26.09.2022; Konkurs me numër të referencës RN0000194 e datës 15.06.2022; Vendim i lëshuar nga Ministria e Mbrojtjes e datës 15.07.2022; Përgjigje në ankesë me numër të protokollit 6992/2022 e datës 10.11.2022; Kërkesë me nr.prot.1448 e datës 06.06.2022; Vendim me nr.prot.1998 e datës 22.07.2022; Lista e aplikantëve; E-mail i dërguar nga S.H drejtuar A.H., F.Z., K.M., L.B., M.Z., A.Z., F.Z. e datës 01.08.2022;Orari për Intervistim për pozitën Zyrtar për Analiza të Blerjeve Ushtarake; E-mail i dërguar nga F.Z drejtuar S.H e datës 02.08.2022; Shkresë me shënimin "Pyetje të Përgjithshme"; Formularët e Vlerësimit në Intervistë për A.H., K.M., L.B., M.SH., me korrespondencën e

bashkangjitur prej 1-20 faqe; Raporti mbi aktivitetin e Komisionit për vlerësimin e kandidatëve sipas vendimit me nr.prot.1998 e datës 22.07.2022 me korrespondencën e bashkangjitur; Të dhënat për komisionin KVLBK; Njoftim Përfundimtarë për kandidatin fitues; E-mail i dërguar nga J.B drejtuar L.B e datës 05.08.2022; E-mail i dërguar nga J.B drejtuar M.SH e datës 05.08.2022; E-mail i dërguar nga J.B drejtuar A.H e datës 05.08.2022; E-mail i dërguar nga J.B drejtuar K.M. e datës 05.08.2022; Njoftimi përfundimtarë për kandidatin fitues i datës 12.08.2022; E-mail i dërguar nga K.M drejtuar J.B e datës 15.09.2022 me korrespondencën e bashkangjitur; Organogrami i Ministrisë së Mbrojtjes; Urdhër Emërim/Gradim për M.Z. me nr.ref.1/66/2019 e datës 11.10.2019; Kontratë Punë për M.Z e datës 21.01.2022; Urdhër Emërim për R.H me nr.ref.1/795/2022 e datës 01.03.2022; Kontratë Punë për R.H e datës 21.01.2012; Ndryshim Plotësim i Akt Emërimit për I.XH i datës 02.03.2020; Ndryshim Plotësim i Akt Emërimit për NJ.A i datës 10.06.2019; Vendim për transferimin e përkohshëm të brendshëm në interes të institucionit Ref.DBN-MM-5/751/2021 i datës 28.12.2021; Raporti Final i Auditimit të Brendshëm në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore me nr.prot.2546 i datës 16.09.2022 me korrespondencën e bashkangjitur prej 1-11 faqe; Të gjeturat për Raportin e Auditimit formulari me numër 3002 i datës 16.09.2022; Plani i Veprimit të Menaxhmentit nr.ref.1/4/37 i datës 16.09.2022; Opinion Kundërshtues me nr.prot.2533 i datës 15.09.2022; Kërkesë me nr.prot.2666 e datës 26.09.2022; E-mail i dërguar nga A.Z drejtuar J.B e datës 08.11.2022 me korrespondencën e bashkangjitur; CV për K.M; Diplomë e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" për K.M. me nr.489 i datës 28.03.2014; Vula Apostile me nr. 3522 e datës 18.09.2015; Vërtetim i Kopjes nga Origjinali LRP.Nr.rendor: 9099/2018 e datës 11.02.2018; Diplomë e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës për K.M me nr.2147 e datës 23.01.2012; Vula Apostile me nr.35521 e datës 18.09.2015; Vërtetim i Kopjes nga Origjinali LRP.Nr.rendor.9098/2018 e datës 11.02.2018; Letër Konfirmimi e lëshuar nga Fakulteti Ekonomik në Osijek për K.M me nr të regjistrimit 2158-96-07-19-9 e datës 01.03.2019; Diplomë e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" për K.M. me nr.3599 e datës 27.10.2015; Certifikatë e lëshuar nga Financial Laë Smart Agency për K.M, nr.04/2017 e datës 04-07 nëntor 2019; Vërtetim e lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë me nr.30/2015 e datës 13.01.2015; Vërtetimi lëshuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë e datës 01.09.2010; Vërtetim mbi mbajtjen e punës Praktike e lëshuar për K.M nga PTK SH.A me Nr.Ark. 4185/10 e datës 19.09.2011; Certifikatë e lëshuar për K.M nga OSCE e datës 06.12.2016; Certifikatë e lëshuar për K.M nga OSCE e datës 21.11.2014; Certifikatë e lëshuar për K.M nga OSCE e datës 29.05.2014; Certifikatë Pjesëmarrje në Konferencën e tretë Internacionale për Biznes e lëshuar për K.M e datës 26.09.2015; Certifikatë Pjesëmarrje në Konferencën e parë Internacionale për Studimet Ndërdisciplinore- Sfida Globale 2015; Certifikatë e lëshuar nga EU-KOSVET VI për K.M e datës 11.06.2014; Certifikatë e lëshuar nga Kolegji FAMA për K.M e datës 19.09.2015; Certifikatë e lëshuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë për K.M Tetor 2013; Certifikatë e lëshuar nga Kolegji European i Kosovës për K.M për periudhën kohore 11.04.2017-11.06.2017; Certifikatë Vlerësimi e lëshuar nga Konferenca Internacionale dhe Puntoria për K.M për periudhën kohore 06.11.2015-09.11.2015; Certifikatë e lëshuar nga ELSLind@star për K.M me nr.10-08 EL F.B e datës 12.04.2008; Certifikatë e lëshuar nga Universiteti Veror Ndërkombëtar i Prishtinës dhe Universiteti i Prishtinës për K.M për periudhën kohore 08.07.2012-20.07.2012 me korrespondencën e bashkangjitur; Certifikatë për pjesëmarrje në trajnim e lëshuar nga Foundation Kosovo Luxembourg për K.M e datës 27.06.2015; Mirënjohje e lëshuar nga Kuvendi i të Rinjëve të

Kosovës për K.M e datës 07.01.2017; Certifikatë për Arritje e lëshuar nga Norëgan Helsingi Committee për K.M për periudhën kohore Shkurt-Qeshor 2014; Certifikatë e lëshuar nga Oda e Avokatëve të Kosovës për K.M e datës 10.06.2015; Certifikatë pjesëmarrje për K.M e lëshuar nga Norëgian Embassy dhe OSCE e datës 20.11.2016; Certifikatë e lëshuar nga Association for Finance and Accounting Services për K.M e datës 05.09.2011; Certifikatë e lëshuar nga Accounting School and Business për K.M për periudhën kohore 01.10.2009 deri 31.12.2009; Certifikatë e lëshuar nga Opinioni i Pavarur Studentor për K.M e datës 02.05.2014; Vendim i lëshuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë i datës 29.05.2014 me nr.01/770 e datës 29.05.2014; Kartela e lëshuar nga Drejtoria e Policisë në Bashkësi për K.M ; Kartelë identifikimi e lëshuar nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë për K.M; Letërnjoftimi; Pasqyra e Llogaris në Trustë për K.M për periudhën kohore 20.06.2001 deri 20.06.2017; Kartelë identifikimi e lëshuar nga Ministria e Financave për K.M; Formulari për Vlerësimin e rezultateve në punë të nënpunësve civil dhe nënpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm i ulët dhe profesional për K.M i datës 10.02.2022; Formulari për Vlerësimin e rezultateve në punë të nënpunësve civil dhe nënpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm i ulët dhe profesional për K.M i datës 05.05.2021; Vërtetim i marrëdhënies së punës e lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë për K.M e datës 04.07.2022; CV për A.H; Letërnjoftim për A.H ; Vërtetim i lëshuar nga Ministria e Ekonomisë për A.H i datës 0.07.2022; Vërtetim e lëshuar nga Policia e Kosovës për A.H e datës 07.07.2022; Certifikatë e lëshuar nga Oda Ekonomike e Kosovës dhe ËKO për A.H e datës dhjetor 2017; Certifikatë e lëshuar nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike për A.H. e datës 17 dhe 18.05.2022; Certifikatë e lëshuar nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike për A.H. e datës 01-02.06.2022; Certifikatë e lëshuar nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike për A.H. e datës 07 dhe 08.04.2022; Certifikatë e lëshuar nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike për A.H. e datës 9,10 dhe 11.03.2022; Certifikatë e lëshuar nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike për A.H. e datës 16 dhe 17 11.2022; Certifikatë e lëshua nga progress për A.H nr.112/2018 e datës 25.06.2018; Certifikatë e lëshua nga Ministria e Financave për A.H nr.173/2017 e datës 05.12.2017; Certifikatë e lëshuar nga CCIT për A.H e datës 06.03.2019; Certifikatë e lëshuar nga Prudencia Consultin për A.H e datës 16.02.2018-19.02.2018; Certifikatë për A.H e lëshuar nga Instituti i Kosovës për Administeratë Publike për periudhën kohore 12-13 shkurt 2015; Certifikatë për A.H e lëshuar nga Instituti i Kosovës për Administeratë Publike për periudhën kohore 26-27 shkurt 2014; Certifikatë për A.H e lëshuar nga Instituti i Kosovës për Administeratë Publike për periudhën kohore 18.10.2012-27.11.2012; Certifikatë për A.H e lëshuar nga Instituti i Kosovës për Administeratë Publike për periudhën kohore 19-20 maj 2011; Certifikatë për A.H e lëshuar nga Instituti i Kosovës për Administeratë Publike për periudhën kohore 14-15 prill 2011; Diplomë e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Ekonomik për A.H me numër 1333 e datës 20.04.2010; Formulari për Vlerësimin e rezultateve në punë të nënpunësve civil dhe nënpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm i ulët dhe profesional për A.H i datës 27.01.2022; Formulari për Vlerësimin e rezultateve në punë të nënpunësve civil dhe nënpunësve të shërbimeve publike për A.H i datës 18.01.2021; Kontrata e marrëdhënies së punës për A.H me numër 192/2010 i datës 01.09.2022; Akt emërim për A.H i datës 10.09.2012; Ndryshimi dhe plotësimi i aktit të emërimit për A.H i datës 01.02.2014; Ndryshimi dhe plotësimi i aktit të emërimit për A.H i datës 01.11.2017; Kërkesë për lëshimin e kartelës identifikuese e datës 25.10.2017; Certifikatë për A.H e lëshuar nga Instituti i Kosovës për

Administeratë Publike për periudhën kohore 17 dhe 18 maj 2022; Certifikatë për A.H e lëshuar nga Instituti i Kosovës për Administeratë Publike për periudhën kohore 01-02 qeshor 2021; Certifikatë e lëshua nga Ministria e Financave për A.H nr.112/2018 e datës 25.06.2018; Certifikatë e lëshuar nga Progress Training Center për A.H për periudhën kohore 15-18 dhjetor 2017; Diplomë e lëshuar nga Oda Ekonomike e Kosovës dhe ËKO për A.H e datës dhjetor 2014; Certifikatë e lëshuar nga Progress Training Center për A.H për periudhën kohore 13.06.2014-15.06.2014; CV për L.B; Diplomë e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës për L.B me nr.119 e datës 30.05.2006; Diplomë e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës për L.B me nr.128 e datës 28.03.2012; Certifikatë për trajnim e lëshuar nga Policia Nacionale e Turqis për L.B për periudhën kohore 15 deri 26 dhjetor 2008; Certifikatë pjesëmarrjese për L.B e lëshuar nga KFOR e datës 06.03.2017; Certifikatë Trajnimi e lëshuar nga AIR communication Solutions ëhen it matters dhe Motorola solutions për L.B e datës dhjetor 2021; Certifikatë e lëshuar nga CTP Consulting AR për L.B me numër të protokollit 114/22 për periudhën kohore 26-27 maj 2022; mVërtetim i lëshuar nga Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë për L.B me nr.ref.07/1-01SAP-P/4898 e datës 21.06.2022; Formulari për Vlerësimin e rezultateve në punë për L.B e datës 10.02.2022; Formulari për Vlerësimin e rezultateve në punë të nënpunësve civil dhe nënpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm i ulët dhe profesional për L.B i datës 28.01.2021; CV për M.SH; Diplomë e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" për M.SH me numër 650 e datës 31.10.2013; Vërtetim i Kopjes nga Origjinali me numër LRP.nr.7713/2019 e datës 16.09.2019; Diplomë e lëshuar nga BPRAL-PPoHE Kolegji AAB me nr.464/19 e datës 03.04.2019; Vërtetim i Kopjes nga Origjinali me numër LRP.nr.7714/2019 e datës 16.09.2019; Kopja e lëtenjoftimit; Formulari për Vlerësimin e rezultateve në punë të nënpunësve civil dhe nënpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm i ulët dhe profesional për M.SH e datës 14.01.2022; Formulari për Vlerësimin e rezultateve në punë të nënpunësve civil dhe nënpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm i ulët dhe profesional për M.SH i datës 28.01.2021; Vërtetim i lëshuar nga Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës për M.SH e datës 14.06.2022; Akt emërim për M.SH i datës 10.09.2019; Kontratë për ekspert të jashtëm profesional të prokurorimit dhe ekspert te jashtëm teknik sipas nevojave të Oganit Shqyrtues të Prokurorimit më numër 617/20 i datës 23.09.2020; Certifikatë e lëshuar nga Cisco Netëorking Academy për M.SH e datës 27.12.2014; Certifikatë e lëshuar nga Business Kosova Center për M.SH e datës Mars 2017; Certifikatë për M.SH e lëshuar nga Instituti i Kosovës për Administeratë Publike për periudhën kohore 24-25 shtator 2019; Certifikatë për M.SH e lëshuar nga Instituti i Kosovës për Administeratë Publike për periudhën kohore 7,8,9 dhe 11 tetor 2019; Certifikatë e lëshuar nga BIT Academy për M.SH e datës janar 2020; Certifikatë e lëshuar nga Training Institute & Center of Kosova për M.SH e datës 26.02.2020; Certifikatë për M.SH e lëshuar nga Instituti i Kosovës për Administeratë Publike për periudhën kohore 10-11 shkurt 2020; Vërtetim i lëshuar nga Quality Pro për M.She datës 15.10.2014; Certifikatë për M.SH e lëshuar nga Instituti i Kosovës për Administeratë Publike për periudhën kohore 24-25 shtator 2020; Certifikatë e lëshuar nga UBT Shkolla Profesionale për M.SH me nr.3976/2-10 e datës korrik 2020; Certifikatë për M.SH e lëshuar nga Instituti i Kosovës për Administeratë Publike për periudhën kohore 14, 15, 16 shtator 2020; Certifikatë për M.SH e lëshuar nga Instituti i Kosovës për Administeratë Publike për periudhën kohore 21, 22, 23 shtator 2020; Certifikatë e lëshuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit dhe Universiteti i Prishtinës "Hasan prishtina" për M.SH me nr.48; Certifikatë Themelore

Profesionale për Prokurim e lëshuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurorimit Publik, Republika e Kosovës dhe Instituti i Kosovës për Administratë Publike për M.SH. me numër 791; Certifikatë e lëshuar nga AUK Training and Development Institute për M.SH e datës 26.03.2021; Certifikatë për M.SH e lëshuar nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike për periudhën kohore 26-28 prill 2021; Certifikatë për M.SH e lëshuar nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike për periudhën kohore 14 mars 2022; Certifikatë e lëshuar nga Ministria e Financave për M.SH me nr.55/2020 e datës 16.06.2020; Certifikatë e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës dhe Norëegan Helsinki Committee për M.SH; Certifikatë e lëshuar nga Smarcode e datës 10.06.2019; Certifikatë e lëshuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë për M.SH e datës tetor 2013; Certifikatë e lëshuar nga Resource Hub Prishtina për M.SH për periudhën kohore 25-27.10.2011; Diplomë e lëshuar nga The Cambrige School për M.SH e datës 16.03.2012; Diplomë e lëshuar nga The Cambrige School për M.SH e datës 09.06.2012; Certifikatë për përfundim e lëshuar nga Shkolla për Integritet Evropian për M.SH e datës 17.12.2014; Certifikatë e lëshuar nga Shkolla për Gjuhët e Huaja për M.SH me numër të protokollit 10/2012 e datës 30.06.2012; Certifikatë e lëshuar nga Shkolla për Gjuhët e Huaja për M.SH me numër të protokollit 11/2012 e datës 02.07.2012; Certifikatë e lëshuar nga Resource Hub Prishtina për M.SH për periudhën kohore 02.04.2012-03.04.2012; Certifikatë e lëshuar nga Resource Hub Prishtina për M.SH për periudhën kohore 12, 12, 13 .09.2012; Certifikatë e lëshuar nga Resource Hub Prishtina për M.SH për periudhën kohore 05, 06, .07.2012; Certifikatë e lëshuar BSC Kosovo; Certifikatë e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës për M.SH i datës 20.03.2013; Certifikatë e lëshuar nga Qendra për Zhvillim të Karrierës për M.SH e datës 20.12.2012; Certifikatë e lëshuar nga ECDL Kosova për M.SH e datës 03.12.2012; Certifikatë e lëshuar nga UNDP për M.SH e datës 23-24.11.2012; Certifikatë e lëshuar nga Agjencia e Përkrahjes së Punësimit Kosovë për M.SH e datës 18.12.2012; CV për F.Z; Diplomë e lëshuar nga Kolegji Biznesi për F.Z me numër 212/14 e datës 24.12.2014; Kopje e letërnjoftimit; Formulari për Vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm i ulët dhe profesional për F.Z i datës 28.01.2021; Dëshmi për masat disiplinore e lëshuar nga Ministria e Mbrojtjes për F.Z i datës 16.06.2022; Akt emërim p-ër D.Z i datës 07.07.2014; Vërtetim për përvojën e punës e lëshuar nga Ministria e Mbrojtjes për F.Z e datës 16.06.2013; Certifikatë e lëshuar nga Republika e Kroacisë për F.Z e datës 23.12.2005; Certifikatë e lëshuar nga Free Eorld Exercise Partners e datës gusht 2003; Certifikatë e lëshuar nga Akademia e Mbrojtjes "Hamzë Jashari" për F.Z për periudhën kohore 26.01.2004-27.04.2004; Certifikatë e lëshuar nga Akademia e Mbrojtjes "Hamzë Jashari" për F.Z për periudhën kohore 26.05.2003-06.06.2003; Certifikatë e lëshuar nga Inter-Galactic EOD dhe Demining Foundation për F.Z e datës 25.08.2001; Certifikatë e lëshuar nga Handicap International për F.Z e datës 28.02.2001; Certifikatë e lëshuar nga Akademia e Mbrojtjes "Hamzë Jashari" për F.Z për periudhën kohore 07.07.2003-11.07.2003.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankueses *është e bazuar, SEPSE:*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave konstaton së në konkursin e shpallur të datës 15.06.2022, për pozitën "Zyrtar për Analiza të Blerjeve Ushtarake", nga Ministria e Mbrojtjes, kriteret formale të konkursit kanë qenë:

• *Diplome Universitare, të studimeve Universitarë-në Ekonomi, Inxhinieri, me të paktën 180, kredi/ECTS-së apo ekuivalente me to.*

• *Se paku dy (2) vite përvoje pune profesionale në fushën për të cilin zhvillohet procedura për plotësim e pozitës së lirë të punës.*

Sa i përket shpalljes së konkursit Kolegji ka analizuar dispozitat e nenit 8 të Ligjit nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë si dhe dispozitat e Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Kosovës me theks të veçantë dispozitat lidhur me lëvizjen brenda kategorisë duke përfshirë edhe përbërjen e komisionit dhe në këto pika, Kolegji i Këshillit konstatuar se procedura e lëvizjes brenda kategorisë sipas konkursit të shpallur me datë 15.06.2022 për pozitën "Zyrtar për Analiza të Blerjeve Ushtarake", Ministria e Mbrojtjes ka vepruar drejt dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Kolegji i Këshillit është lëshuar në trajtim të pretendimeve të ankueses për arsye të anulimit të konkursit të lartpërmendur, dhe pas analizimit të gjitha shkresave të lëndës të bashkëngjitura nga palët në procedurë ka konstatuar se Ministria e Mbrojtjes ka shpallur konkursin me datë 15.06.2022 dhe ka respektuar dispozitat e shpalljes së konkursit, gjithashtu pas shpalljes së konkursit sipas shkresave të lëndës ka bërë respektimin e të gjitha fazave të konkursit paraparë tek dispozitat për lëvizje brenda kategorisë, sikurse konstatohet fakti se ankuesja i ka plotësuar kriteret e e përcaktuara të konkursit të datës 15.06.2022. Pas përmbjlljes së intervistës me gojë, dhe njoftimit përfundimtar të kandidatit të suksesshëm, nga shkresat e administruara të lëndës është konstatuar fakti se ndaj të njëjtës procedurë të rekrutimit, asnjëri nga kandidatët pjesëmarrës nuk ka parashtruar ankesë, ndërsa njoftimi përfundimtar i kandidatit të suksesshëm i datës 05.08.2022 e ka përmbajtur këshillën juridike për të drejtën e ushtrimit të mjetet ankimore sipas dispozitave të përcaktuara me nenin 50 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Pas përfundimit të gjithë procedurës së lëvizjes brenda kategorisë për pozitën e lartshënuar, me kërkesë të Sekretarit të Përgjithshëm dhe me miratim të Ministrit të Mbrojtës më datë 25.08.2022 Auditori i Brendshëm i Ministrisë së Mbrojtës ka bërë një auditim të konkurseve në Ministrinë e Mbrojtjes lidhur me lëvizjen brenda kategorisë dhe sipas raportit të ZAB të MM në faqen 5 të raportit tek përmbledhja ekzekutive auditori i brendshëm i konstaton dy mangësi që kanë hasur citoj "Mos kuptimi i drejtë i kushteve të konkursit tek kërkesat e përgjithshme formale-tek përvoja e punës 2 (dy) vite përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës, nga DBNJ ka ndikuar në verifikimin paraprak të kandidatëve të cilët nuk e kanë plotësuar kriterin për pozitën për të cilën kanë aplikuar dhe jo në harmoni sipas nenit 45 të Rregullores QRK 16/2020" mbyllet citati. Gjithashtu në faqen 6 të këtij raporti ku Auditori i Brendshëm listën "Është vërejtur për të mire" se pika 2. Citoj "konkurset brenda kategorisë janë bërë në harmoni me legjislacion".

Kolegji i ka analizuar vetëm këto dy citate të lartshënuar në raport dhe ka konstatuar se Auditori i Brendshëm në Ministrinë e Mbrojtjes në këtë raport bie në kundërthënie të hapur me atë që e shkruan vetë, prandaj Kolegji pas analizimit të gjitha shkresave të lëndës të bashkëngjitura nga palët në procedura ka konstatuar se procedura për pozitën "Zyrtar për Raportime dhe Analiza" në Ministrinë e Mbrojtjes është bërë konform dispozitave ligjore në fuqi.

Me datë 27.09.2022, Drejtoria e Burimeve Njerëzore/Departamenti për Politika ka njoftuar kandidaten e pazgjidhur se në bazë të rekomandimeve të Auditorit të Brendshëm dhe kërkesës së Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm për zbatimin e rekomandimeve të Auditorit të Brendshëm, anulohet konkursi i datës 15.06.2022 për pozitën "Zyrtar për Analiza të Blerjeve Ushtarake" me Nr. Referencës: RN00009194.

Kolegji i Këshillit, duke marrë për bazë se anulimi i konkursit për pozitën e lartshënuar është bërë duke u bazuar në raportin e Auditorit të Brendshëm, duke mos përfillur afatin për parashtrim të ankesave eventuale në KPMSHC, ka konstatuar se Ministria e Mbrojtës ka vepruar në kundërshtim me nenin 24 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë ku përcaktohet se: "...3. Nëpunësi civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil sipas këtij ligji. E drejta e ankimit në KPMSHC i njihet edhe çdo kandidati në një procedurë pranimi në Shërbimin Civil. Pas shterimit të drejtës së ankimit në KPMSHC, mund të iniciohet konflikt administrativ në gjykatën kompetente për çështjet administrative", sepse të drejtë ekskluzive në procedurën administrative për vendimmarrje lidhur me marrëdhënien e punës në shërbimin civil të Kosovës, sipas ankesave të ankuesve është Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e drejtë kjo e cila buron nga neni 101 paragrafi 2 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës ku përcaktohet se "Një Këshill i Pavarur Mbikëqyrës për shërbimin civil siguron respektimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil dhe i cili pasqyron diversitetin e popullit të Republikës së Kosovës".

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi që ka pranuar ankesën e ankueses lidhur me anulimin e procedurës së rekrutimit për pozitën "Zyrtar për Analiza të Blerjeve Ushtarake" në Ministria e Mbrojtjes, pas administrimit të provave dhe vërtetimit të drejtë të gjendjes faktike, konstaton se procedura e lëvizjes brenda kategorisë për pozitën "Zyrtar për Analiza të Blerjeve Ushtarake" është zhvilluar në pajtim me nenin 38 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, dhe dispozitave të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, andaj Kolegji i Këshillit, konstaton se vlerësimi i kandidateve është bërë në pajtim të plotë me nenin 47 të Rregullores (QRK) nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ndërsa edhe rezultati përfundimtar është në pajtim me nenin 48 dhe 49 të kësaj rregulloreje

Kolegji i Këshillit, pas konstatimeve si më lartë, vlerëson se Ministria e Mbrojtës, nga fillimi i procedurës së rekrutimit deri të njoftimi për kandidatin e suksesshëm, ka vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafi 1, 2 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ku përcaktohet se: "**1. Pranimi në detyrë i nëpunësit civil, bazohet në parimet e mundësive të barabarta, meritës dhe integritetit, mos diskriminimit dhe përfaqësimit të drejtë dhe proporcional gjinor dhe të komuniteteve. 2. Pranimi, sipas paragrafit 1 të këtij neni, kryhet nëpërmjet një procesi përzgjedhës profesional, transparent e të drejtë, që garanton mundësi të barabarta për kushte të barabarta dhe përzgjedhjen e kandidatëve më të kualifikuar për kryerjen e detyrave përkatëse, duke garantuar përfaqësim minimal të komuniteteve dhe të gjinive**".

Nisur nga këto, Kolegji i Këshillit konstaton se njoftimi për anulimin e kësaj procedurë mbi bazën e raportit të Auditorit të Brendshëm është në kundërshtim të plotë me dispozitat e Ligjit

Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë si dhe dispozitat e Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe është në kundërshtim me nenin 47 dhe 48 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, andaj edhe pretendimet e ankueses janë të bazuara. Po ashtu, me rastin e trajtimit të kësaj lëndë Këshilli i ka marr parasysh edhe dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative neni 132 paragrafi 6 ku përcaktohet se: "Ankesa nuk do të përkeqësoj situatën juridike në dëm të palës që ka paraqitur ankesë, përpos nëse shprehimisht është paraparë ndryshe me ligj".

Kolegji i Këshillit, thekson faktin se, organi i punësimi Ministria e Mbrojtës, është e obliguar që pas pranimit të këtij vendimi, të ndër marrë të gjitha veprimet sipas diapozitivit të këtij vendimi dhe të veprojë në pajtim me Ligjin Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, si dhe Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.931/2022

Elakron GASHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mbrojtjes;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Mbrojtjes, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.